

Dita ndërkombëtare e Parlamentarizmit: Parlamentet për Planetin

Çfarë ka bërë Kuvendi i Kosovës për çështjet e mjedisit?

Kuvendi i Kosovës ndër çështjet e shumta që i shqyrton sipas funksionit kushtetues, trajton edhe temat që ndërlidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e tij. Në përbërje të trupave të tij, Kuvendi ka një komision parlamentar specifik i cili trajton çështjet të cilat kanë të bëjnë me ambientin, konkretisht Komisionin për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim. Por edhe komisionet tjera parlamentare i trajtojnë këto tema, në rastet kur ligjet të cilat kanë të bëjnë me mjedisin shqyrtohen kah aspekti buxhetor apo i harmonizimit me direktivat evropiane. Gjatë këtij sesiioni në Komisionin për Mjedis janë trajtuar tema si gjendja e mjedisit në vend, projektligji për pyjet dhe Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”. Për këtë të fundit komisioni ka realizuar edhe një dëgjim publik gjatë të cilit ka raportuar edhe ministri Liburn Aliu.

Ndërsa, që nga fillimi i legjislaturës së re të Kuvendit në mars të vitit 2021, Kuvendi ka miratuar gjithsej 13 ligje që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mbrojtjen e mjedisit. Ndër më kryesoret janë Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, i miratuar në qershor të vitit 2022, Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis, i miratuar me 15 dhjetor 2022, dhe ligjet tjera që përfshijnë mbeturinat, mbrojtjen e bimëve, gjuetinë, pyjet, rregullimin e tokës etj. Kuvendi gjatë këtij viti ka miratuar edhe Strategjinë e Energjisë 2022-2031, e cila si komponentë ka edhe konsolidimin e energjisë së gjelbër.

Përveç ligjeve janë miratuar edhe marrëveshje për kredi, me qëllim realizmin e projekteve të gjelbërta siç është ai për efikasitetin e energjisë në ndërtesa publike në Prishtinë -ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, i miratuar në mars të këtij viti.

Në proces të miratimit janë edhe ndryshim-plotësimi në ligjin për energjinë dhe Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë në mes të Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin “Ngrohtorja solare e Prishtinës”.

Një ligj i rëndësishëm që ndërlidhet me çështjen e mjedisit, e i cili është ende në pritje të miratimit nga ana e Kuvendi është ai për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Ky ligj është në proces të plotësimi ndryshimet, por ndonëse ka qenë pjesë e rendit të ditës në dhjetëra seanca ende nuk ka marrë aprovimin e deputetëve. Duke konsideruar rëndësinë e këtij ligji në rrethana ku ndërtimet pa leje mbeten problematikë në nivel nacional, miratimi i këtij ligji është nevojë urgjente.

Ndonëse Kuvendi është treguar efikas në trajtimin e çështjeve që ndërlidhen me mjedisin duke miratuar një sërë të ligjeve që prekin, deputetët nuk kanë qenë shumë aktiv në kërkim të llogaridhënies për çështjet që ndërlidhen me mjedisin. Gjaët këtij sesiioni deputetët kanë parashtruar vetëm dy pyetje parlamentare, ndaj ministrit të Ambientit Liburn Aliu dhe ministres për Ekonomi Artane Rizvanolli.

Në anën tjetër, mbetet ende punë për tu bërë nga ana e deputetëve në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të lartpërmendura, duke përfshirë edhe vizitat në terren për të parë nga afër efektin e këtyre ligjeve dhe zbatimin e tyre në praktikë.